



BOSCH

Register your
new device on
MyBosch now and
get free benefits:
**[bosch-home.com/
welcome](https://bosch-home.com/welcome)**



Kombinim për ftohje dhe ngrirje

KAI..

sq Udhëzim për përdorim dhe montim

Përmbajtja

Udhëzime sigurie	3	Shkrrirja e ushqimeve të ngrira	12
Rreth këtij udhëzuesi	3	Dhoma ftohëse	13
Rrezik shpërthimi	3	Për t'u patur kujdes gjatë vendosjes në pajisje	13
Rrezik goditjeje elektrike	3	Kini parasysh zonat e ftohta në dhomën ftohëse ..	13
Rrezik djegieje nga i ftohti	3	Mbajtësja e frutave dhe perimeve	13
Rrezik lëndimi	3	Super ftohja	13
Parandalimi i rreziqeve për fëmijët dhe personat e rrezikuar	4	Aktivizimi i super ftohjes	13
Përcaktime të përgjithshme	4	Çaktivizimi i super ftohjes	13
Dëme materiale	4	Depozita e ujit	14
Pesha	4	Mbushja e depozitës së ujit	14
Udhëzime për asgjësimin	4	Alarmi i depozitës së ujit	14
Asgjësimi i ambalazhit	4	Dispenseri i akullit dhe ujit	15
Asgjësimi i pajisjes së vjetër	4	Nxjerrja e ujit	15
Përmbajtja e ambalazhit	4	Akullbërësi	15
Montimi i pajisjes	5	Nxjerrja e akullit	15
Transporti	5	Organizimi i ndryshueshëm i hapësirës së brendshme	16
Çmontimi i dyerve të pajisjes	5	Funksioni i alarmit	17
Vendi i montimit	5	Alarmi i derës	17
Bazamenti	5	Modaliteti i pushimeve	17
Bëni kujdes me temperaturën dhe ajrimin e dhomës	5	Aktivizimi i modalitetit të pushimeve	17
Montimi i ndarësit	6	Çaktivizimi i modalitetit të pushimeve	17
Përmasat e montimit dhe këndi i hapjes së derës ..	6	Modaliteti i kursimit të energjisë	17
Shtrengoni dorezën	6	Aktivizimi i modalitetit të kursimit të energjisë	17
Nivelimi i pajisjes	6	Çaktivizimi i modalitetit të kursimit të energjisë	17
Niveli dyert	7	Fikja dhe nxjerrja e pajisjes jashtë pune	18
Instalimi i pajisjes	7	Fikja e pajisjes	18
Instalimi elektrik	7	Nxjerrja e pajisjes jashtë pune	18
Njohja me pajisjen	8	Shkrrirja	18
Paneli i komandimit dhe i treguesve	9	Dhoma e ngrirjes	18
Ndezja e pajisjes	10	Dhoma ftohëse	18
Siguresa e fëmijëve	10	Pastrimi i pajisjes	18
Anulimi i bllokimit të butonave	10	Metoda	18
Aktivizimi i bllokimit të butonave	10	Dispenseri i akullit dhe ujit	18
Vendosja e temperaturës	10	Pjesët përbërëse	19
Dhoma e ngrirjes	10	Pastrimi i depozitës së ujit	19
Dhoma ftohëse	10	Përdorimi i mbajtëses së kubave të akullit	20
Kapaciteti	10	Shkrrirja	21
Dhoma e ngrirjes	11	Ndriçimi (LED)	21
Blerja e ushqimeve të ngrira	11	Kursim i energjisë	21
Mbajtëset e ushqimeve të ngrira	11	Zhurmat e punës	21
Shfrytëzoheni plotësisht vëllimin e ngrirjes së shpejtë	11	Zhurmat krejtësisht normale	21
Kapaciteti i ngrirjes	11	Parandalimi i zhurmave	21
Ngrirja e ushqimeve të freskëta	11	Si të rregulloni vetë problemet e vogla	22
Paketimi i ushqimeve të ngrira	11	Shërbimi i klientit	23
Jetëgjatësia e ushqimeve të ngrira	12	Kontrata e riparimeve dhe këshillimi në rast defektesh	23
Kalendari i ngrirjes	12		
Super ngrirja	12		
Aktivizimi i super ngrirjes	12		
Çaktivizimi i super ngrirjes	12		

Udhëzime sigurie

Kjo pajisje përputhet me normat e sigurisë në fuqi për pajisjet elektrike dhe mund t'i mposhtë interferencat.

Qarku i lëndës ftohëse është testuar për hermeticitet.

Rreth këtij udhëzuesi

- Lexoni dhe ndiqni udhëzuesin e montimit dhe të përdorimit. Atje do të gjeni informacione të rëndësishme për montimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes.
- Prodhuesi nuk mban përgjegjësi nëse nuk respektohen udhëzimet dhe paralajmërimet e këtij udhëzuesi përdorimi dhe montimi.
- Ruajini të gjithë dokumentet për t'iu referuar në të ardhmen dhe për përdoruesin e ardhshëm.

Rrezik shpërthimi

- Mos përdorni asnjëherë pajisje elektrike brenda pajisjes (p.sh. pajisje ngrohëse ose aparate elektrike për akull).
- Mos ruani në pajisje produkte me lëndë djegëse (p.sh. shishe spërkatëse) dhe lëndë shpërthyes.
- Shishet me alkool me përqindje të lartë ruajini në pajisje të mbyllura mirë dhe më këmbë.
- Pavarësisht të dhënave të prodhuesit, mos ndërmerrni asnjë masë shtesë për të përshpejtuar shkrirjen e akullit.

Rrezik goditjeje elektrike

Instalimet dhe riparimet e gabuara mund ta vënë përdoruesin në rrezik të madh.

- Kur montoni pajisjen në vend, bëni kujdes që kabli i rrjetit të mos ketë ngecur e mos jetë dëmtuar.
- Kur kabli i rrjetit është i dëmtuar: Shkëputeni pajisjen nga rrjeti.
- Mos përdorni priza me shumë fole, kablllo zgjatues ose adaptues.

- Pajisja duhet të riparohet vetëm nga prodhuesi, nga shërbimi i klientit ose nga një person i kualifikuar përkatësisht.
- Përdorni vetëm pjesë origjinale nga prodhuesi. Për këto pjesë, prodhuesi garanton përmbushjen e kriterëve të sigurisë.

Rrezik djegieje nga i ftohti

- Ushqimin e ngrirë të saponxjerrë nga sirtari i ngrirjes mos e fusni menjëherë në gojë.
- Shmangni kontaktin e zgjatur të lëkurës me ushqimin e ngrirë, me akullin dhe me tubat në sirtarin e ngrirjes.

Rrezik lëndimi

Shishet me pije të gazuara mund të pëlcasin. Mos vendosni shishe me pije të gazuara në sirtarin e ngrirjes.



Rrezik djegieje ose të tjera nga lënda ftohëse

Në tubat e qarkut të lëndës ftohëse qarkullon në sasi të vogël një lëndë ftohëse (R600a) e padëmshme për ambientin por e djegshme. Ajo nuk e dëmton shtresën e ozonit dhe nuk e rrit efektin serë. Kur del jashtë lëndë ftohëse, ajo mund të dëmtojë sytë ose mund të marrë flakë.

- Mos i dëmtoni tubat.

Nëse dëmtohen tubat:

- Mbani larg pajisjes burime zjarri apo ndezëse.
- Ajrosni dhomën.
- Fikni pajisjen dhe hiqni spinën nga priza.
- Telefonojini shërbimit të klientit.



Rrezik djegieje

Prizat me shumë fole dhe ushqyesit portativë mund të mbinxehen dhe të shkaktajnë zjarr.

Mos vendosni mbrapa pajisjes priza me shumë fole dhe ushqyes portativë.

Parandalimi i rreziqeve për fëmijët dhe personat e rrezikuar

Janë të rrezikuar:

- fëmijët,
- personat që janë kufizime fizike, psiqike ose perceptive,
- personat që nuk kanë njohuri të mjaftueshme për përdorimin e sigurt të pajisjes.

Masat:

- Sigurohuni që fëmijët dhe personat e rrezikuar t'i kenë kuptuar rreziqet.
- Fëmijët dhe personat e rrezikuar duhet të mbikëqyren ose të shoqërohen gjatë përdorimit të pajisjes, nga një person përgjegjës për sigurinë e tyre.
- Lejoni vetëm fëmijë mbi 8 vjeç ta përdorin pajisjen.
- Mbikëqyrni fëmijët kur lani apo mirëmbani pajisjen.
- Mos i lini asnjëherë fëmijët të luajnë me pajisjen.

Rrezik nga mbytja

- Mos ua lini fëmijëve ambalazhin dhe pjesët e tij.

Përcaktime të përgjithshme

- Kjo pajisje është projektuar për përdorim shtëpiak dhe për mjedisin e shtëpisë.
- Mbusheni depozitën e ujit vetëm me ujë të pijshëm.
- Kjo pajisje është projektuar për t'u përdorur deri në një lartësi maksimale prej 2000 metrash mbi nivelin e detit.

Dëme materiale

Për të shmangur dëmet materiale:

- Mos shkelni dhe mos hipni mbi xokol, mbi pjesët e dala apo mbi dyer.
- Pjesët plastike dhe guarnicionet e derës mbajini pastër nga vaji apo yndyra.
- Për ta hequr nga priza, tërhiqni spinën dhe jo kabllin.

Pesha

Pajisja është shumë e rëndë. Montimi dhe transportimi i pajisjes duhet të kryhet gjithmonë me të paktën 2 persona.

Udhëzime për asgjësimin

Asgjësimi i ambalazhit

Paketimi e mbron pajisjen tuaj nga dëmtimet gjatë transportit. Të gjitha materialet e përdorura janë ekologjike dhe të riciklueshme. Ju lutemi të jepni kontributin tuaj si më poshtë: Asgjësojeni paketimin sipas normave ekologjike.

Lidhur me mënyrat aktuale të asgjësimit, informohuni pranë shitësit tuaj të specializuar ose organeve vendore.

Asgjësimi i pajisjes së vjetër

Pajisjet e vjetra nuk janë për t'u hedhur! Me anë të asgjësimit të padëmshëm për mjedisin, prej tyre mund të rifitohen lëndë të para me vlerë.



Ky aparat përmban shënjen e aparaturave elektrike dhe elektroteknike sipas Udhëzimit 2012/19/EU (waste electrical and electronic equipment – WEEE). Udhëzimi jep kuadrin ligjor për te drejtën e kthimit mbrapsht të aparaturave të përdorura në të gjithë BE.



Paralajmërim

Për pajisjet që nuk përdoren më

1. Hiqni spinën e rrjetit.
2. Priteni kabllin elektrik dhe hiqeni bashkë me spinën.
3. Mos i nxirrni raftet dhe enët, në mënyrë që fëmijët të mos hyjnë dot në pajisjen e boshatisur!
4. Mos i lini fëmijët të luajnë me pajisjen e papërdorur. Rrezik asfiksie!

Pajisjet ftohëse përmbajnë lëndë ftohëse dhe gaze në pjesët e izoluara. Lënda ftohëse dhe gazet duhet të asgjësohen në mënyrën e duhur. Tubat dhe qarkun e lëndës ftohëse mos i dëmtoni deri në momentin e asgjësimit të duhur.

Përmbajtja e ambalazhit

Pas shpaktimit të pajisjes, kontrolloni të gjitha pjesët nëse janë dëmtuar nga transporti. Në rast se keni ankesa, drejtojeni shitësit tek i cili keni blerë pajisjen ose shërbimit të klientit.

Ambalazhi përmban pjesët e mëposhtme:

- Pajisjen
- Qeskën me materiale për montimin
- Pjesët përbërëse (në varësi të modelit)
- Udhëzues përdorimi
- Broshurën e shërbimit të klientit
- Shtojca e garancisë
- Informacione për konsumin e energjisë dhe zhurmat

Montimi i pajisjes

Transporti

Pajisja është e rëndë. Sigurojeni gjatë transportit dhe montimit!

Për shkak të peshës dhe të përmasave të pajisjes, si dhe për të zvogëluar rrezikun e lëndimeve ose të dëmeve në pajisje, nevojiten të paktën dy persona për montimin e sigurt të pajisjes.

Çmontimi i dyerve të pajisjes

Nëse pajisja nuk hyn dot tek dera e banesës, mund të zhvidhosni dyert.

Kujdes!

Zhvidhosja e dyerve të pajisjes duhet të bëhet vetëm nga shërbimi i klientit.

Vendi i montimit

Për montimin duhet një dhomë e thatë dhe e ajrosur mirë. Vendi i montimit nuk duhet të jetë nën rrezatimin e drejtpërdrejtë të rrezeve të diellit dhe jo në afërsi të një burimi nxehtësie si soba, radiator etj. Kur montimi pranë një burimi nxehtësie është i pashmangshëm, përdorni një pllakë të përshtatshme izoluese ose ruani distancat e mëposhtme minimale nga burimi i nxehtësisë:

- 3 cm nga sobat elektrike apo me gaz.
- 30 cm nga sobat me vajguri ose me qymyr.

Në rastin e montimit pranë një pajisjeje tjetër ftohëse ose ngrirëse duhet ruajtur një distancë minimale anësore prej 25 mm, për të shmangur formimin e kondensimit.

Nëse pajisja është veshur sipër me një mbulesë ose një dollap, duhet parashikuar një hapësirë prej 30 mm, në mënyrë që pajisja të mund të nxirret nga zgavra, sipas nevojës.

Ajri i ngrohtë në anën e pasme të pajisjes duhet të dalë pa pengesa.

Bazamenti

Kujdes!

Pajisja është shumë e rëndë. Dyshemeja në vendin e montimit nuk duhet të bëjë bark. Nëse nevojitet, përforconi dyshemën.

Në mënyrë që dyert të mund të hapen deri në fund, gjatë montimit në qoshen e dhomës ose në zgavrën e posaçme, ruani distancat minimale (→ Kapitulli "Përmasat e montimit").

Nëse thellësia e dollapëve të kuzhinës ngjitur me pajisjen tejkalon 60 cm, duhet të ruhen distancat minimale anësore, në mënyrë që të shfrytëzohet këndi i plotë i hapjes së derës (→ Kapitulli "Këndi i hapjes së derës").

Bëni kujdes me temperaturën dhe ajrimin e dhomës

Temperatura e dhomës

Kategorinë e klimës e gjeni në tabelën e tipit.

Aty jepen kufijtë e temperaturës brenda së cilave mund të përdoret pajisja. Tabela e tipit ndodhet djathtas në dhomën ftohëse.


Kategoria e klimës	Temperatura e lejuar e ambientit
SN	+10 °C deri 32 °C
N	+16 °C deri 32 °C
ST	+16 °C deri 38 °C
T	+16 °C deri 43 °C

Udhëzim:

Pajisja është plotësisht funksionale brenda kufijve të temperaturës së dhomës për kategorinë e dhënë të klimës. Nëse një pajisje e kategorisë së klimës SN përdoret në temperatura ambienti më të ftohta, dëmtimet në pajisje mund të përjashtohen deri në një temperaturë +5 °C.


Ajrimi

Rrotull pajisjes nevojitet një ajrim i mirë. Ajri i ngrohur duhet të dalë pa pengesa. Përndryshe, pajisja ftohëse do të punojë më shumë. Kjo rrit konsumin e energjisë. Për këtë arsye rrotull pajisjes duhet të ketë hapësirë të lirë të mjaftueshme. Rekomandim: 50 deri 70 mm nga pjesa e pasme deri tek muri, të paktën 100 mm në pjesën e sipërme dhe të paktën 100 mm midis pjesëve anësore dhe murit, me hapësirë të lirë të mjaftueshme përpara, për të hapur derën e dhomës së ngrirjes deri në 130° dhe derën e dhomës ftohëse deri në 135°.




Montimi i ndarësit

Hiqini të dyja vidat me ndihmën e një kaçavide. Nxirreni ndarësin nga qeska dhe fiksojeni atë me vida në anën e derës së pajisjes. Kështu do të ruhet distanca minimale nga muri.




Përmasat e montimit dhe këndi i hapjes së derës



W	W1	W2	D	D1
908 mm	418 mm	277 mm	628 mm	1171 mm

Shtrëngoni dorezën



Ju lutemi t'i provoni dorezat e pajisjes, para se ta përdorni atë. Nëse një nga dorezat është e lirë, shtrëngojeni atë në drejtim kundërorar me një çelës hekzagon.



Nivelimi i pajisjes

Në mënyrë që pajisja të funksionojë sa më mirë, duhet të nivelohet me ndihmën e një niveluesi me ujë.


- Për një nivelim të mjaftueshëm dhe ajrim në pjesën e poshtme dhe të pasme të pajisjes, mund të jetë e nevojshme të përshtatni këmbëzat e rregullueshme.
- Në mënyrë që dyer të mbyllën vetë, me rrotullimin e këmbëzave të rregullueshme anojeni pjesën e sipërme me rreth 15 mm ose 0,5° nga mbrapa.
- Nëse doni ta lëvizni pajisjen, mendoni të rrotulloni sërish për lart këmbëzat e rregullueshme, në mënyrë që të mund të lëvizje lirisht.
- Rrotat janë të ngurta dhe duhet të përdoren vetëm për lëvizjet përpara dhe mbrapa. Gjatë lëvizjeve anësore, bazamenti dhe rrotat mund të dëmtohen.
- Pasi ndryshoni vendin e pajisjes, duhet ta niveloni sërish.



Niveli dyert

Nëse dyert nuk janë në të njëjtën lartësi, dera e dhomës ftohëse mund të përshtatet me një kaçavidë.

Vetëm dera e dhomës ftohëse mund të përshtatet.



Për të ngritur derën e dhomës ftohëse, rrotullojeni dadon (1) në drejtim kundërorar.

Për të ulur derën e dhomës ftohëse, rrotullojeni dadon (1) në drejtim orar.

Kur dera të nivelohet si duhet, fiksojeni me dadon (2).

Instalimi i pajisjes

Pajisja duhet të montohet dhe të instalohet nga një specialist, në përputhje me udhëzuesin e montimit bashkëngjitur.

Siguresat e transportit të rafteve dhe mbajtëseve hiqini vetëm pas montimit të pajisjes.

Krahas rregulloreve të parashikuara ligjore kombëtare duhet të respektohen kushtet e instalimit të ndërmarrjes energjetike vendore.

Pas montimit të pajisjes, prisni të paktën 1 orë, derisa pajisja të vihet në punë. Gjatë transportit mund të ndodhë që vaji që ndodhet në kompresor të zhvendoset në sistemin ftohës.

Para se ta vini në punë për herë të parë, pastrojeni pajisjen nga brenda
(→ Kapitulli "Pastrimi i pajisjes").

Instalimi elektrik

⚠ Paralajmërim – Rrezik nga goditja elektrike!

Nëse gjatësia e kabllit të rrjetit nuk mjafton, mos përdorni në asnjë mënyrë spina të shumëfishta ose kablo zgjatues. Në këtë rast, kontaktoni shërbimin e klientit për alternativat e mundshme.

Për instalimin e pajisjes nevojitet një prizë e instaluar fiks.

Priza duhet të jetë afër pajisjes dhe lehtësisht e arritshme edhe pas montimit të pajisjes.

Pajisja përkon me kategorinë mbrojtëse I. Lidhni pajisjen në një prizë me përçues mbrojtës të instaluar sipas rregullave në rrymë alternative 220-240 V / 50 Hz. Priza duhet të sigurohet me një siguresë 10-A deri 16-A ose më shumë.

Në pajisjet që do të vihen në punë në vendet jo-evropiane, duhet të kontrollohet nëse tensioni dhe lloji i rrymës së dhënë përputhen me vlerat e rrjetit tuaj elektrik. Tabela e tipit ndodhet djathtas poshtë pajisjes. Nëse nevojitet të ndërrohet kabli i rrjetit, kjo duhet të bëhet vetëm nga një specialist.

⚠ Paralajmërim


Pajisja nuk duhet të lidhet në asnjë mënyrë në një spinë elektronike që kursen energji.

Për përdorimin e pajisjeve tona mund të përdorni invertera sinusoidalë dhe me tension rrjeti. Inverterat me tension rrjeti përdoren në rastin e impianteve fotovoltaike, të cilët lidhen direkt në rrjetin elektrik publik. Në rastet e zgjidhjeve të izoluara (p.sh. në anije ose në kabina malore), ku nuk bëhet lidhja direkte me rrjetin elektrik publik, duhet të përdoren invertera sinusoidalë.

Njohja me pajisjen

Udhëzim:

Për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme në produktet tona, pajisja juaj mund të ketë ndryshime të vogla nga ç'paraqitet në këtë udhëzues. Megjithatë, funksionet dhe përdorimi vazhdojnë të jenë të njëjta.



A Dhoma e ngrirjes


- 1 Ndriçimi LED i dhomës së ngrirjes
- 2 Mbulesa ballore e akullbërësit
- 3 Mbulesa e ajrimit të dhomës së ngrirjes
- 4 Moduli i mbajtëses së kubave të akullit
- 5 Rafti në dhomën e ngrirjes
- 6 Rafti i derës së dhomës së ngrirjes
- 7 Guarnicioni i derës së dhomës së ngrirjes
- 8 Mbajtësja e sipërme e ushqimeve të ngrira
- 9 Mbajtësja e poshtme e ushqimeve të ngrira
- 10 Rafti i derës në dhomën e ngrirjes (ndarja me 2 yje)

B Dhoma ftohëse

- 11 Ndriçimi LED i dhomës ftohëse
- 12 Mbulesa e ajrimit të dhomës ftohëse
- 13 Rafti në dhomën ftohëse
- 14 Rafti i derës së dhomës ftohëse
- 15 Depozita e ujit
- 16 Mbajtësja e frutave dhe perimeve
- 17 Mbajtësja e poshtme e dhomës ftohëse
- 18 Guarnicioni i derës së dhomës ftohëse
- 19 Këmbëza të rregullueshme

Paneli i komandimit dhe i treguesve

Paneli i komandimit dhe i treguesve tek dera përbëhet nga 2 fusha treguesish për temperaturën, tregues për llojet e ndryshme të funksioneve dhe 9 butona të funksioneve.



- | | |
|--|---|
| 1 Butoni "Freezer / super 3s" (ngrirësi / super 3s)
Për të vendosur temperaturën e dhomës së ngrirjes. | 11 Treguesi (holiday) (pushime)
Ndizet kur modaliteti i pushimeve është aktiv. |
| 2 Butoni "ice on/off" (akulli aktiv/joaktiv)
Për aktivizimin/çaktivizimin e sinjalit. | 12 Butoni "holiday" (pushime)
Për aktivizimin/çaktivizimin e modalitetit të pushimeve. |
| 3 Treguesi (ice off) (akulli joaktiv)
Ndizet kur akullbërësi është aktiv. | 13 Treguesi i temperaturës për dhomën ftohëse |
| 4 Treguesi (super ngrirje)
Ndizet kur funksioni "super ngrirje" është aktiv. | 14 Treguesi (super ftohje)
Ndizet kur funksioni "super ftohje" është aktiv. |
| 5 Treguesi i temperaturës për dhomën e ngrirjes | 15 Treguesi (eco) (ekonomik)
Ndizet kur modaliteti i kursimit të energjisë është aktiv. |
| 6 Butoni "alarm / lock/unlock 3s" (alarm / kyçje/shkyçje 3s)
Për fikjen e alarmit të derës.
Për aktivizimin/çaktivizimin e bllokimit të butonave dhe funksionin e dispenserit (siguresa e fëmijëve). | 16 Butoni "eco / no water tank 3s"
Për aktivizimin/çaktivizimin e modalitetit të kursimit të energjisë.
Për të fikur alarmin e depozitës së ujit. |
| 7 Treguesi (alarm)
Ndizet kur dera ka alarm. | 17 Butoni "Fridge / super 3s" (frigoriferi / super 3s)
Për vendosjen e temperaturës së dhomës ftohëse. |
| 8 Treguesi (bllokimi i butonave)
Ndizet kur siguresa e fëmijëve është aktive. | 18 Butonin e dispenserit të akullit/uji vendosen në modalitetin e punës "ujë". |
| 9 Treguesi i modalitetit të punës së dispenserit të akullit/ujit:
Modaliteti i punës "kuba akulli" është aktiv.
Modaliteti i punës "akull i thërrmuar" është aktiv.
Modaliteti i punës "ujë" është aktiv. | 19 Butonin e dispenserit të akullit/uji vendosen në modalitetin e punës "akull i thërrmuar". |
| 10 Treguesi (alarmi i depozitës së ujit)
Alarmi i depozitës së ujit (depozita nuk është vendosur ose nuk është vendosur saktë). | 20 Butonin e dispenserit të akullit/uji vendosen në modalitetin e punës "kuba akulli". |

Ndezja e pajisjes

Kur pajisja ndizet, do të ndizet edhe ndriçimi i sfondit të treguesve në panelin e komandimit dhe treguesve. Të gjithë treguesit ndizen për 3 sekonda dhe tingëllon sinjalizuesi. Nëse nuk shtypet asnjë buton dhe dyert janë të mbyllura, ndriçimi i sfondit do të fiket pas 60 sekondash.

Temperaturat e paravendosura do të arrihen pas më shumë orëve. Mos vini ushqime në pajisje para këtij momenti.

Nga fabrika rekomandohen temperaturat e mëposhtme:

- Dhoma e ngrirjes: -18 °C
- Dhoma ftohëse: +4 °C

Udhëzim:

Pas ndezjes së pajisjes, siguresa e fëmijëve është çaktivizuar.

Siguresa e fëmijëve

Kur treguesi  ndizet, butonat janë bllokuar dhe dispenser i akullit/ujit është çaktivizuar.

Anulimi i bllokimit të butonave

Shtypni butonin "alarm / lock/unlock 3s" (alarm / kyçje/shkyçje 3s) për 3 sekonda, për të anuluar bllokimin e butonave dhe për të aktivizuar dispenserin e akullit/ujit. Treguesi  fiket.

Aktivizimi i bllokimit të butonave


Shtypni butonin "alarm / lock/unlock 3s" (alarm / kyçje/shkyçje 3s) për 3 sekonda, për të bllokuar butonat dhe për të çaktivizuar dispenserin e akullit/ujit. Treguesi  ndizet.

Vendosja e temperaturës

Dhoma e ngrirjes

Temperatura në dhomën e ngrirjes mund të vendoset nga -14 °C deri në -24 °C. Ju rekomandojmë të vendosni vlerën -18 °C.

Pas anulimit të bllokimit të butonave, cilësimet e temperaturës janë aktive. Shtypni butonat "Freezer / super 3s" (ngrirësi / super 3s), për ta vendosur temperaturën sipas nevojës nga -14 °C deri në -24 °C. Vlera përkatëse do të shfaqet në ekran në rendin e mëposhtëm.




Dhoma ftohëse

Temperatura në dhomën ftohëse mund të vendoset nga +2 °C deri në +8 °C. Ju rekomandojmë të vendosni vlerën +4 °C.

Ushqimet delikate nuk duhet të vendosen në temperatura më të ngrohta sesa +4 °C.

Pas anulimit të bllokimit të butonave, cilësimet e temperaturës janë aktive. Shtypni butonat "Fridge / super 3s" (frigoriferi / super 3s), për ta vendosur temperaturën sipas nevojës nga 8 °C deri në 2 °C. Vlera përkatëse do të shfaqet në ekran në rendin e mëposhtëm.



Kapaciteti

Të dhënat e kapacitetit i gjeni në tabelën e tipit të produktit në pajisje (→ Kapitulli "Shërbimi i klientit").

Dhoma e ngrirjes

Përdorimi i dhomës së ngrirjes

- për ruajtjen e ushqimeve të ngrira.
- për prodhimin e kubeve të akullit.
- për ngrirjen e ushqimeve.

Kujdes!

Mos i lini shishet më shumë se ç'duhet në ndarjen e ngrirjes, pasi mund të thyhen nga ngrirja.

Udhëzim:

Bëni kujdes që dera e dhomës së ngrirjes të qëndrojë gjithmonë e mbyllur mirë! Kur dera është e hapur, ushqimet e ngrira shkrijnë dhe dhoma e ngrirjes krijon shtresë akulli. Përveç kësaj: Ka humbje energjie nga konsumi i lartë i energjisë!

Pas mbylljes së dhomës së ngrirjes, dera qëndron në nënpresion, gjë që shkakton zhurma thithëse. Prisni dy deri në tre minuta, derisa nënpresioni të jetë balancuar.

Blerja e ushqimeve të ngrira

- Paketimi nuk duhet të jetë i dëmtuar.
- Shihni datën e skadencës.
- Temperatura në frigoriferin e dyqanit duhet të jetë -18 °C ose më e ftohtë.
- Mundësisht transportojeni ushqimin e ngrirë në një qeskë të izoluar dhe futeni shpejt në dhomën e ngrirjes.

Mbajtëset e ushqimeve të ngrira

Mbajtëset e ushqimeve të ngrira duhet të montohen nëpër shinat rrëshqitëse dhe mund të mbajnë sasi të mëdha ushqimi të ngrirë.

Për të nxjerrë një mbajtëse të ushqimeve të ngrira, tërhiqeni atë përpara dhe ngrijeni nga sirtaret. Nxirreni paraprakisht ushqimin e ngrirë.

Pas nxjerrjes së ushqimeve të ngrira, futini sërish sirtarët deri në fund.

Shfrytëzohen plotësisht vëllimin e ngrirjes së shpejtë

Nëse nuk ju nevojitet akull, mund ta çaktivizoni akullbërësin dhe në vend të mbajtëses së kubave të akullit, vendosni raftin e derës (→ Kapitulli "Pastrimi i pajisjes").

Kapaciteti i ngrirjes

Të dhënat rreth kapacitetit të ngrirjes i gjeni në tabelën e tipit.

Ngrirja e ushqimeve të freskëta

Për ngrirjen përdorni vetëm ushqime të freskëta dhe pa probleme.

Për të ruajtur sa më mirë vlerën ushqimore, aromën dhe ngjyrën e perimeve, jepini një valë në ujë të nxehtë para se t'i ngrini. Në rastin e patëllxhanëve, specave, kungujve dhe shpargullit, procesi i zierjes paraprake nuk është i nevojshëm.

Në librari mund të gjeni literaturë të posaçme për ngrirjen dhe zierjen paraprake.

Udhëzim:

Ushqimet që do të ngrini mos i vini në kontakt me ushqimet e sapongrira.

- Janë të përshtatshme për ngrirje: Prodhime brumi, peshk dhe fruta deti, mish, mish dreri, mish shpendësh, perime, fruta, erëza, vezë pa lëvozhgë, produkte qumështi si djathi, gjalpë dhe gjiza, gatesa të gatshme dhe ushqime të mbetura si supëra, gjellë me mish, mish dhe peshk i gatuar, gatesa me patate, tava dhe gatime të ëmbla.
- Nuk janë të përshtatshme për ngrirje: Llojet e perimeve që zakonisht hahen të gjalla, si sallatë jeshile ose rrepa, vezë me lëvozhgë, rrush, mollë të plota, dardha dhe pjeshkë, vezë të ziera, kos, qumësht milk, salcë kosi, krem djathi dhe majonezë.

Paketimi i ushqimeve të ngrira

Ushqimet paketojini në mënyrë hermetike që të mos e humbin shijen e të mos thahen.

1. Vendosini ushqimet në paketim.
2. Nxirni jashtë ajrin.
3. Mbylleni paketimin në mënyrë hermetike.
4. Shkruani mbi ambalazh përmbajtjen dhe datën që e keni futur në ngrirje.

Materialet e përshtatshme për paketim:

Fletë plastike, qese cilindrike prej polietileni, letër alumini, kuti të posaçme për ngrirje.

Këto produkte i gjeni në dyqan.

Materialet e papërshtatshme për paketim:

Letër dhuratash, letër furre, celofan, qese plehrash dhe qese të përdorura pazari.

Të përshtatshme për mbylljen e paketimit:

Llastikë gome, kapëse plastike, spango, ngjitëse të qëndrueshme ndaj të ftohtit etj.

Qeskat dhe qeset cilindrike prej polietileni mund të puthiten me një pajisje të posaçme për mbylljen e qeseve.

Jetëgjatësia e ushqimeve të ngrira

Jetëgjatësia varet nga lloji i ushqimit.

Në temperaturën -18 °C:

- Peshku, sallami, gatesat e gatshme, prodhimet e brumit:
deri në 6 muaj
- Djathi, mishi, shpendët:
deri në 8 muaj
- Perimet, frutat:
deri në 12 muaj

Kalendari i ngrirjes

2 – 6 months	   
4 – 8 months	   
6 – 12 months	   
	

Për të shmangur uljen e cilësisë së ushqimit të ngrirë, mos e tejkaloni kohëzgjatjen e ruajtjes. Kohëzgjatja e ruajtjes varet nga lloji i ushqimit të ngrirë. Numrat dhe simbolet japin kohëzgjatjen e lejuar në muaj të ushqimit të ngrirë.

Respektoni në ushqimet që i blini të ngrira, datën e prodhimit dhe atë të skandencës.

Super ngrirja

Ushqimet duhet të ngrihen sa më shpejt dhe plotësisht, në mënyrë që të mund të ruhen vitaminat, vlerat ushqyese dhe shija.

Pajisja punon gjithë kohën kur aktivizohet super ngrirja. Temperaturat në dhomën e ngrirjes janë shumë më të ulëta sesa në modalitet normal.

Aktivizojeni super ngrirjen disa orë para se të futni ushqime të freskëta, për të shmangur një rritje të padëshiruar të temperaturës.

Nëse kapaciteti i ngrirjes duhet të shfrytëzohet sipas tabelës së tipit, aktivizojeni super ngrirjen 24 orë para se të futni produktet e freskëta në dhomën e ngrirjes.

Sasitë e vogla të ushqimit (deri në 2 kg) mund të ngrihen pa super ngrirjen.

Aktivizimi i super ngrirjes

Shtypni butonin "Freezer / super 3s" (ngrirësi / super 3s) për 3 sekonda, për të aktivizuar funksionin super ngrirja.

Treguesi ❄ (super ngrirja) ndizet dhe shfaqet temperatura e dhomës së ngrirjes prej "-24 °C".

Çaktivizimi i super ngrirjes

Shtypni butonin "Freezer / super 3s" (ngrirësi / super 3s), për të aktivizuar funksionin super ngrirja.

Nëse është çaktivizuar super ngrirja, treguesi ❄ (super ngrirja) do të fiket. Pajisja kthehet automatikisht mbrapsht në temperaturën që ishte përpara super ngrirjes.

Udhëzime

Pas 52 orësh, super ngrirja do të çaktivizohet automatikisht.

Me aktivizimin e modalitetit të pushimeve dhe të kursimit të energjisë, funksioni super ngrirja çaktivizohet.

Shkrirja e ushqimeve të ngrira

Në varësi të llojit dhe qëllimit të përdorimit mund të zgjidhni ndër alternativat e mëposhtme:

- në temperaturë ambiente
- në frigorifer
- në furrë elektrike, me/ose ventilim
- në pajisjen me mikrovalë

Kujdes!

Ushqimet e ngrira që janë shkrirë njëherë, mos i ngrini sërish.

Vetëm pas përgatitjes së një gatese të gatshme (të zier ose të pjekur) mund ta ngrini sërish.

Mos përdorni më kohëzgjatjen maksimale për ruajtjen e ushqimit të ngrirë.

Dhoma ftohëse

Dhoma ftohëse është vendi ideal i ruajtjes së ushqimeve si mishi, sallami, produktet e qumështit, vezët, ushqimet e gatshme dhe prodhimet e brumit.

Për t'u patur kujdes gjatë vendosjes në pajisje

- Vendosni në pajisje ushqime të freskëta dhe të paprishura. Në këtë mënyrë cilësia dhe freskia ruhet më gjatë.
- Në produktet e gatshme dhe ushqimet e paketuara bëni kujdes qëndrueshmërinë dhe datën e skadencës së specifikuar nga prodhuesi.
- Për të ruajtur aromën dhe freskinë, sistemojini ushqimet e paketuara mirë dhe të mbuluara. Në këtë mënyrë do të shmangët përzierja e aromave të ushqimeve dhe çngjyrosja e pjesëve plastike në dhomën ftohëse.
- Gatesat dhe pijet e ngrohta lërin fillimisht të ftohen e më pas vendosini në pajisje.

Udhëzim:

Shmangni kontaktin midis ushqimeve dhe murit të pasmë të pajisjes. Përndryshe, qarkullimi i ajrit do të ndikohet.

Ushqimet ose ambalazhet mund të ngrijnë e të ngjiten pas murit të pasmë të pajisjes.

Kini parasysh zonat e ftohta në dhomën ftohëse

Për shkak të qarkullimit të ajrit në dhomën ftohëse, krijohen zona të ndryshme ftohjeje:

- Zona më e ftohtë është midis mbajtëses së perimeve dhe raftit të xhamit sipër tij.

Udhëzim:

Ushqimet delikate (p.sh. peshku, sallami, mishi) vendosini në zonën më të ftohtë të mbajtëses së perimeve.

- Zona më e ngrohtë është në pjesën më të sipërme të derës.

Udhëzim:

Në zonën më të ngrohtë vendosni p.sh. djathë të fortë dhe gjalpë. Djathi e ruan aromën gjatë dhe gjalpi qëndron i butë për t'u shtruar.

Mbajtësja e frutave dhe perimeve

Mbajtësja është montuar mbi shinat rrëshqitëse dhe shërben për ruajtjen e frutave dhe perimeve.

Për të nxjerrë një mbajtëse, tërhiqeni atë përpara dhe ngrijeni nga sirtaret. Nxirrni paraprakisht gjithë ushqimet.

Pas nxjerrjes së mbajtëses, futini sërish sirtarët deri në fund.

Udhëzime

- Frutat e ndjeshme ndaj të ftohtit (p.sh. ananasi, banania, papaja dhe agrumet) dhe perimet (p.sh. patëllxhanë, tranguj, kunguj, specat, domate dhe patate) duhet të ruhen në temperatura prej rreth +8 °C deri +12 °C për ruajtjen optimale të cilësisë dhe të aromës jashtë frigoriferit.
- Në varësi të sasisë së ushqimit që do të ruani në pajisje, në mbajtësen e perimeve mund të krijohet ujë i kondensuar. Hiqeni ujin e kondensuar me një leckë të thatë.

Super ftohja

Me super ftohjen, dhoma ftohëse ftohet sa më shumë të jetë e mundur.

Aktivizoni super ftohjen, p.sh.

- para se të futni sasi të mëdha ushqimi.
- për ftohjen e shpejtë të pijeve.

Aktivizimi i super ftohjes

Shtypni butonin "Fridge / super 3s" (frigoriferi / super 3s) për 3 sekonda, për të aktivizuar funksionin super ftohja.

Treguesi ❄ (super ftohja) ndizet dhe shfaqet temperatura e dhomës ftohëse prej "2 °C".

Çaktivizimi i super ftohjes

Shtypni butonin "Fridge / super 3s" (frigoriferi / super 3s), për të aktivizuar funksionin super ftohja.

Nëse është çaktivizuar super ftohja, treguesi ❄ (super ftohja) do të fiket. Pajisja kthehet automatikisht mbrapsht në temperaturën që ishte përpara super ftohjes.

Udhëzime


Pas 3 orësh, super ftohja do të çaktivizohet automatikisht.

Me aktivizimin e modalitetit të pushimeve dhe të kursimit të energjisë, funksioni super ftohja çaktivizohet.


Depozita e ujit

Depozita e ujit shërben për furnizimin me ujë të prodhuesit të akullit dhe të dispenserit të ujit.

Mbushja e depozitës së ujit




1. Tërhiqeni paksa jashtë depozitën e ujit.



2. Hapni kapakun e vogël përpara dhe mbusheni aty direkt me ujë.

Kujdes!

- Mbusheni depozitën e ujit vetëm me ujë të pijshëm.
- Sasia maksimale e mbushjes është maksimumi 4,5 litra.



3. Shtyni përsëri saktë në vend depozitën e ujit.

Udhëzim: Pas futjes së depozitës, pritni për 10 sekonda përpara se të kërkohet ujë.

Alarmi i depozitës së ujit

Nëse depozita e ujit nuk është vendosur ose nuk është futur si duhet, për t'ia sinjalizuar këtë përdoruesit ndizet treguesi .

Shtypni butonin "eco / no water tank 3s" për 3 sekonda, për të fikur alarmin.

Dispenseri i akullit dhe ujit

Sipas nevojës, mund të merrni:

- ujë të ftohtë
- kuba akulli
- akull të thërrmuar

Akullin apo ujin mund ta zgjidhni duke shtypur butonin  (kuba akulli),  (akull të thërrmuar) ose  (ujë).

Paralajmërim


- Mos përdorni enë të thyeshme për marrjen e ujit ose të akullit, pasi ka rrezik që qelqi të thyhet!
- Mos i futni duart në zgavrën e nxjerrjes pasi ka rrezik lëndimi nga thikat thërrmuese!

Udhëzim:

Dispenseri i akullit dhe i ujit nuk funksionon nëse dera e dhomës së ngrirjes është e hapur ose siguresa e fëmijëve është aktive.

Nxjerrja e ujit

Uji në dispenserin e ujit është i ftohtë aq sa duhet për t'u pirë. Nëse dëshironi që uji të jetë më i ftohtë, para se të hapni rubinetin, shtoni në gotë kuba akulli.



1. Shtypni butonin , për ta vendosur dispenserin e akullit/ujit në modalitetin e punës "ujë". Treguesi  ndizet, kur modaliteti i punës "ujë" është aktiv.
2. Shtyni gotën kundrejt levës së dispenserit. Uji ndalon së rrjedhuri në momentin që e hiqni gotën nga leva. Mos e hiqni gotën plotësisht menjëherë, por mbajeni edhe 2 deri 3 sekonda nën dispenser, për të shmangur pikimet.

Udhëzim:

Nëse nuk del fare ujë apo nëse uji del shumë ngadalë, kontrolloni nëse depozita e ujit është lidhur saktë dhe sigurohuni që depozita është e mbushur mjaftueshëm.

Akullbërësi

Kur dhoma e ngrirjes arrin temperaturën e ngrirjes, në akullbërës do të rrjedhë ujë dhe do të ngrijë në formë kubash akulli. Sapo të jenë gati kubat e akullit, ata do të shkarkohen automatikisht nga mbajtësja e kubave të akullit.

Çaktivizimi i akullbërësit

Për të kursyer ujë dhe energji, akullbërësi do të çaktivizohet nëse nuk nevojitet akull.


Për ta çaktivizuar apo aktivizuar akullbërësin, shtypni butonin "ice on/off" (akulli aktiv/joaktiv). Treguesi  (ice off) (akulli joaktiv) ndizet kur akullbërësi është i çaktivizuar.

Udhëzim: "ice on/off" (akulli aktiv/joaktiv) ka të bëjë vetëm me akullbërësin, jo me dispenserin e akullit/ujit.

Zbrazja e mbajtësës së kubave të akullit

Nëse nuk keni nxjerrë akull për një kohë të gjatë, kubat e akullit mund të ngrijnë ngjitur me njëri-tjetrin në mbajtësen e tyre. Në këtë rast, nxirrni mbajtësen dhe boshatiseni (→ Kapitulli "Pastrimi i pajisjes").

Nxjerrja e akullit




1. Shtypni butonin  ose , për ta vendosur dispenserin e akullit/ujit në modalitetin e punës "kuba akulli" ose "akull i thërrmuar". Treguesi përkatës  ose  ndizet kur modaliteti i zgjedhur i punës është aktiv.
2. Shtyni një enë të përshtatshme kundrejt levës së dispenserit. Hiqeni enën nga leva kur është mbushur pothuajse përgjysmë. Akulli që ndodhet në zonën e nxjerrjes mund të shkaktojë derdhje të enës ose të bllokojë nxjerrjen. Mos e hiqni enën plotësisht menjëherë, por mbajeni edhe 2 deri 3 sekonda nën dispenser, për të shmangur pikimet.

Udhëzime


- Pas kalimit nga "kuba akulli" në "akull i thërrmuar" në dispenser mund të ndodhen ende kuba akulli të plota ose të pjesshme. Ato dalin me copëzat e para të "Akullit të thërrmuar".
- Pas kalimit nga "akull i thërrmuar" në "kuba akulli" në dispenser mund të ndodhet ende një sasi e vogël "akulli të thërrmuar". Ajo del jashtë me kubat e parë të akullit.
- Në modalitetin normal të punës, mos e nxirrni akullin më gjatë se 1 minutë pa ndërprerje, për të shmangur një mbinxehje të motorit thërrmues.

Organizimi i ndryshueshëm i hapësirës së brendshme

Dhoma ftohëse është e pajisur me 5 rafte qelqi dhe disa rafte të ndryshme dere, të cilat shërbejnë për vendosjen e vezëve, kanaçeve, shisheve të pijeve dhe ushqimeve të paketuara. Sipas nevojës, mund të përdorni secilën prej tyre në lartësi të ndryshme. Para se t'i nxirrni jashtë, boshatisini nga ushqimet raftet e derës, për të shmangur derdhjet.




- Për heqjen e një rafti, tërhiqeni atë me kujdes përpara, derisa të lirohet nga shinat.
- Kur rivendosni raftet, sigurohuni që të mos ketë asnjë pengesë mbrapa dhe që ta shtyni raftin me kujdes në pozicionin e vet.



- Ngrini raftin e derës e më pas hiqeni.

Rafti i shisheve (opsional) shërben për vendosjen e verës dhe të pijeve të tjera në shishe.

Udhëzim: Kur nxirrni shishet, bëni kujdes.



- Rafti mund të nxirret për t'u pastruar ose për të kursyer vend.

Funksioni i alarmit

Kur bie një alarm, ndizet treguesi  dhe tingëllon një sinjal.

Alarmi i derës

Nëse dera e dhomës së ngrirjes ose e dhomës ftohëse qëndron e hapur më shumë se dy minuta, ndizet alarmi i derës.

Kur tingëllon alarmi i derës, sinjalizuesi tingëllon 3 herë në minutë dhe do të ndalojë automatikisht pas 10 minutash.

Për të kursyer energji, duhet të shmangni mbajtjen hapur të pajisjes gjatë përdorimit për kohë të gjatë.

Duke mbyllur derën, alarmi do të pushojë.

Me derën hapur, alarmi mund të ndalohet duke shtypur butonin "alarm / lock/unlock 3s" (alarm / kyçje/shkyçje 3s), nëse siguresa e fëmijëve nuk është aktive.

Modaliteti i pushimeve

Në rast mungesash të gjata, modaliteti i pushimeve është zgjedhja më e mirë. Në këtë modalitet pune, temperatura në dhomën ftohëse do të vendoset 15 °C dhe në dhomën e ngrirjes -18 °C, për të minimizuar konsumin e energjisë.

E rëndësishme: Gjatë kësaj kohe, mos ruani ushqim në dhomën ftohëse.

Aktivizimi i modalitetit të pushimeve

Shtypni butonin "holiday" (pushime) për të aktivizuar modalitetin e pushimeve.

Treguesi  (holiday) (pushime) ndizet dhe shfaqet temperatura e dhomës ftohëse prej "15 °C".

Udhëzim: Në modalitetin e pushimeve, akullbërësi do të çaktivizohet automatikisht.

Çaktivizimi i modalitetit të pushimeve

Shtypni butonin "holiday" (pushime) për të çaktivizuar modalitetin e pushimeve.

Nëse modaliteti i pushimeve është çaktivizuar, treguesi  (holiday) (pushime) do të fiket në panelin e treguesve. Pajisja kthehet automatikisht mbrapsht në temperaturën që ishte vendosur përpara.

Modaliteti i kursimit të energjisë

Modaliteti i kursimit të energjisë mund t'ju ndihmojë për të reduktuar konsumin e energjisë. Ai e vendos temperaturën e dhomës ftohëse në 6 °C dhe temperaturën e dhomës së ngrirjes në -17 °C.

Aktivizimi i modalitetit të kursimit të energjisë

Shtypni butonin "eco / no water tank 3s", për të aktivizuar modalitetin e kursimit të energjisë.

Treguesi  (eco) (ekonomik) ndizet kur modaliteti i kursimit të energjisë është aktiv.

Çaktivizimi i modalitetit të kursimit të energjisë

Shtypni butonin "eco / no water tank 3s", për të çaktivizuar modalitetin e kursimit të energjisë.

Nëse modaliteti i kursimit të energjisë është çaktivizuar, treguesi  (eco) (ekonomik) do të fiket në panelin e treguesve. Pajisja kthehet automatikisht në temperaturën që ishte vendosur përpara.

Fikja dhe nxjerrja e pajisjes jashtë pune

Fikja e pajisjes

Hiqni spinën ose fikni siguresën.

Pajisja ftohëse fiket.

Kujdes!

Nëse pajisja është fikur për një kohë shumë të gjatë, akulli shkrin në mbajtësen e kubave të akullit dhe rrjedh nga pajisja në dyshe. Për ta shmangur këtë, duhet të boshatiset mbajtësja e kubave të akullit (→ Kapitulli "Pastrimi i pajisjes").

Udhëzim: Siguresa e fëmijëve dhe funksionet e super ngrirjes dhe të super ftohjes nuk ruhen nëse pajisja fiket.

Nxjerrja e pajisjes jashtë pune

Nëse nuk do ta përdorni pajisjen për kohë të gjatë:

1. Nxirrini të gjitha ushqimet nga pajisja.
2. Hiqni spinën ose fikni siguresën.
3. Pastroni pajisjen nga brenda dhe boshatisni mbajtësen e kubave të akullit (→ Kapitulli "Pastrimi i pajisjes").
4. Lërin dyert e pajisjes të hapura, për të shmangur formimin e erërave.

Shkrirja

Dhoma e ngrirjes

Përmes sistemit pa ngrirje NoFrost, dhoma e ngrirjes qëndron pa akull. Shkrirja nuk është më e nevojshme.

Dhoma ftohëse

Shkrirja bëhet automatikisht.

Uji i shkrirjes qarkullon përmes vrimës së shkarkimit në një enë avullimi në pjesën e pasme të pajisjes.

Pastrimi i pajisjes

⚠ Paralajmërim

Mos e pastroni asnjëherë pajisjen me një pajisje pastrimi me avull!

Kujdes!

- Mos përdorni solucione pastrimi ose tretëse me përmbajtje rëre, klori ose acidi.
- Mos përdorni sfungjerë të ashpër ose gërryes. Në sipërfaqet metalike mund të ndodhë korrozion.
- Mos përdorni objekte të mprehta për të hequr ngricën nga dhoma ftohëse.
- Mos i pastroni asnjëherë raftet dhe mbajtëset në enëlarëse. Pjesët mund të shformohen!

Metoda


1. Hiqni spinën ose fikni siguresën.
2. Nxirrni jashtë pajisjes ushqimet dhe vendosini në një vend të freskët.
3. Prisni derisa shtresa e ngricës të ketë shkrirë.
4. Pastrojeni pajisjen me një leckë të butë, me ujë të vakët dhe me pak lëng larës me pH neutral. Uji shpëlarës nuk duhet të hyjë tek ndriçimi.
5. Pastrojeni guarnicionin e derës me ujë të pastër e më pas thajeni mirë me leckë.
6. Pas pastrimit, lidheni pajisjen sërish. Hapësira e brendshme duhet të jetë plotësisht e thatë, para se të futni spinën dhe të ndizni pajisjen.
7. Futni sërish brenda ushqimet e ngrira.

Dispenseri i akullit dhe ujit

- Mos e tërhiqni nga leva e dispenserit. Susta e levës mund të dëmtohet ose të thyhet.

Pastroni enën e pritjes së ujit dhe të rrjetës

Uji që rrjedh mblidhet në enën pritëse të ujit.



- Për pastrimin e enës pritëse të ujit dhe të filtrit, ky i fundit mund të nxirret jashtë.


Pjesët përbërëse

Për pastrimin, nxirrini të gjitha pjesët e ndryshueshme të pajisjes (→ Kapitulli "Organizimi i ndryshueshëm i hapësirës së brendshme").

Udhëzim:

Për nxjerrjen dhe pastrimin e mbajtëseve, hapini dyert plotësisht mbi 90°.

Nxirrni mbajtëset




- Tërhiqeni mbajtësen plotësisht jashtë dhe nxirrni duke e liruar nga foleja.


Kur e futni, pozicionojeni mbajtësen mbi shinat rrëshqitëse dhe shtyjeni në hapësirën e brendshme. Mbajtësja mbërthehet duke e shtypur për poshtë.

Pastrimi i depozitës së ujit

Depozita e ujit duhet pastruar rregullisht.



1. Nxirrni jashtë plotësisht depozitën e ujit.




2. Hiqni kapakun e depozitës.
3. Lani pjesën e brendshme të depozitës dhe kapakun dhe shpëlajeni me ujë të pastër.
4. Montoni përsëri depozitën e ujit dhe shtyjeni prapa në vend.


Përdorimi i mbajtëses së kubave të akullit

Nxirri mbajtësen e kubave të akullit

Për pastrimin ose nëse nuk nevojitet akull, mbajtësja e kubave të akullit mund të hiqet.



1. Mbajeni mbajtësen e kubave të akullit tek doreza dhe shtyjeni për lart.
2. Nxirreni ngadalë për të shmangur dëmtimet.



Paralajmërim

Mos i futni gishtat, duart ose objektet e papërshtatshme tek rrëshqitësja e akullit ose tek akullbërësi. Kjo mund të shkaktojë lëndime dhe dëme materiale.


Udhëzim: Ka një tubacion uji për akullbërësin. Mos e çmontoni vetë gjithë sistemin e furnizimit me ujë. Kjo duhet të kryhet nga persona të kualifikuar.

Boshatisni mbajtësen e kubave të akullit dhe pastrojeni

Mbajtësja e kubave të akullit duhet të boshatiset, nëse kubat e akullit janë ngjitur me njëri-tjetrin ose nëse nuk është nxjerrë akull për një kohë të gjatë ose kur pajisja është e fikur.


Për pastrimin, përdorni lëndë pastruese të buta, më pas shpëlajeni mirë dhe thajeni. Mos përdorni lëndë pastruese të mprehta ose gërryese apo solucione tretëse.

Zëvendësoni mbajtësen e kubave të akullit




Nëse nuk ju nevojitet akull, akullbërësi çaktivizohet dhe në vend të mbajtëses së kubave të akullit (1), përdorni raftin e derës (2), për të krijuar më shumë hapësirë në dhomën e ngrirjes.

Montoni mbajtësen e kubave të akullit



1. Sigurohuni që të dyja bashkueset të jenë në një kënd të përshtatshëm, për t'u kapur me njëra-tjetrën. Nëse nevojitet, rrotullojeni bashkuesen tek mbajtësja e kubave të akullit, në mënyrë që të përshtatet me bashkuesen e motorit.



2. Mbajeni mbajtësen e kubave të akullit tek doreza dhe shtyjeni për lart. Për këtë sigurohuni që mbajtësja e kubave të akullit (B) të mbërthehet në të dyja anët tek kapëset (A) të akullbërësit.
3. Tërhiqeni poshtë mbajtësen e kubave të akullit dhe kontrolloni nëse ka qëndrim të sigurt.

Shkrirja

Edhe pse pajisja shkrin automatikisht, në muret e brendshme të dhomës së ngrirjes mund të formohet ngricë, nëse dera hapet shpesh ose qëndron hapur për kohë të gjatë.

Nëse shtresa e ngricës është shumë e trashë, prisni derisa të pakësohet sasia e ushqimit dhe veproni si vijon:

1. Hiqni ushqimet e pranishme dhe raftet, hiqni spinën nga priza dhe lërini dyert hapur. Për të përshpejtuar procesin e shkrirjes, ajroseni dhomën mirë.
2. Nëse procesi i shkrirjes ka përfunduar, pastrojeni pajisjen siç përshkruhet më lart.

Ndriçimi (LED)

Pajisja juaj është e pajisur me një ndriçim LED që nuk ka nevojë për mirëmbajtje.

Riparimet në mekanizmin e ndriçimit duhet të kryhen vetëm nga shërbimi i klientit ose nga specialistë të autorizuar.

Kursim i energjisë

- Montojeni pajisjen në një dhomë të thatë dhe me ajrosje. Pajisja nuk duhet të qëndrojë direkt nën rrezatimin e diellit ose në afërsi të burimeve të nxehtësisë (p.sh. radiatorë, soba).
- Mos i bllokoni vrimat e daljes së ajrit në pajisje.
- Ushqimet dhe pijet e ngrohta lërini fillimisht të ftohen e më pas vendosini në pajisje.
- Vendoseni ushqimin e ngrirë në dhomën ftohëse për t'u shkrirë, në mënyrë që ftohtësia e ushqimit të ngrirë të shfrytëzohet për ftohjen e ushqimeve.
- Hapeni pajisjen sa më shkurt të mundeni.
- Bëni kujdes që dera e dhomës së ngrirjes të qëndrojë gjithmonë e mbyllur mirë.
- Organizimi i pjesëve të brendshme nuk ka asnjë ndikim në absorbimin e energjisë së pajisjes.
- Për të kursyer ujë dhe energji, akullbërësi do të çaktivizohet nëse nuk nevojitet akull.

Zhurmat e punës

Zhurmat krejtësisht normale

- Zhurmat e punës së kompresorit.
- Zhurmat e lëvizjes së ajrit nga motori i vogël i ajrit në dhomën ftohëse ose në pjesët e tjera.
- Zhurma si gurgullimë, të ngjashme me ujin që zien.
- Zhurmë trokitëse gjatë shkrirjes automatike.
- Zhurmë klikimi para se të fillojë kompresori.
- Zhurma kur akullbërësi lëshon poshtë kuba akulli në mbajtësen e kubave të akullit.
- Nëse shtypet butoni , pompa e ujit ndizet dhe për sa kohë që është në punë e sipër, lëshon një zhurmë të dobët.

Parandalimi i zhurmave

Pajisja nuk është në nivel

Nivelojeni pajisjen me ndihmën e një niveluesi me ujë. Për këtë, përdorni këmbëzat e rregullueshme ose vendosni diçka nën të.

Pajisja "është në nivel"

Largojeni pajisjen nga mobilet ose pajisjet në afërsi.

Mbajtëset ose sipërfaqet mbështetëse lëvizin ose ngecin

Kontrolloni pjesët që nxirren jashtë dhe futini sërish në vend.

Shishet ose enët prekin njëra-tjetrën

Largojini shishet dhe enët me kujdes nga njëra-tjetra.

Si të rregulloni vetë problemet e vogla

Përpara se t'i telefononi shërbimit të klientit:

Provoni nëse mund ta rregulloni vetë defektin përmes udhëzimeve të mëposhtme.

Kostot për këshillimin me shërbimin e klientit duhet t'i merrni përsipër vetë – edhe gjatë periudhës së garancisë!


Defekti	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Pajisja nuk funksionon	Spina nuk është futur mirë në prizë.	Kontrolloni nëse spina është futur mirë në prizë.
	Siguresa është e fukur ose ka defekt.	Kontrolloni siguresën e nëse nevojitet, zëvendësojeni.
	Shkëputje korrenti.	Kontrolloni furnizimin me energji.
	Temperaturë shumë e ulët mjedisi.	Përpiquni që të zgjidhni problemin duke ulur temperaturën e vendosur.
	Është normale që pajisja të mos punojë gjatë procesit automatik të shkrirjes, ose për pak kohë pas ndezjes së pajisjes, për të mbrojtur kompresorin.	
Zhurma nga hapësira e brendshme	Hapësira e brendshme është e ndotur.	Pastroni hapësirën e brendshme.
	Disa ushqime, mbajtëse ose paketime shkaktajnë zhurmë.	
Motori punon pa pushim	Është normale të dëgjoni shpesh zhurmë të motorit. Në kushtet e mëposhtme, motori duhet të punojë më shpesh: ■ Temperatura e vendosur është më e ftohtë se nevojitet. ■ Para pak kohe është futur një sasi e madhe ushqimi të ngrohtë në pajisje. ■ Temperatura e mjedisit është shumë e lartë. ■ Dyert janë lënë hapur shumë gjatë ose janë hapur shumë shpesh. ■ Pas vënies në punë ose kur pajisja nuk ka qenë e fukur për kohë të gjatë.	
Në hapësirën e brendshme formohet një shtresë ngrice	Vrimat e daljes së ajrit janë bllokuar; ajrim i pamjaftueshëm; dera nuk është mbyllur mirë.	Sigurohuni nëse vrimat e daljes së ajrit janë mbuluar nga ushqimi dhe nëse ushqimi është vendosur në mënyrë të tillë në pajisje, që të garantohet një ajrim i mjaftueshëm. Kontrolloni nëse dera është mbyllur mirë. Për të hequr ngricën: → Kapitulli "Pastrimi i pajisjes".
Temperatura në pajisje është shumë e ngrohtë	Ka mundësi që dyert të jenë lënë hapur shumë gjatë dhe shumë shpesh; ose dyert janë lënë hapur nga ndonjë pengesë e mundshme; ose pajisja është montuar me hapësirë të lirë të pamjaftueshme nëpër anë, poshtë ose lart.	Mos i hapni dyert pa qenë nevoja ose më shumë se ç'nevojitet; kontrolloni hapësirën e lirë përreth pajisjes.
Dyert hapen me vështirësi	Pajisja nuk është anuar me rreth 15 mm nga mbrapa. Ka diçka në hapësirën e brendshme që pengon mbylljen e dyerve.	Kontrolloni animin dhe nëse nevojitet, korrigjoni duke rrotulluar këmbëzat e rregullueshme. Kontrolloni hapësirën e brendshme dhe pengesën.
Ndriçimi nuk funksionon	Ndriçimi LED është fukur automatikisht sepse dera ka ndenjur hapur shumë gjatë. Ndriçimi LED ka defekt.	Mbyllni derën dhe hapeni prapë, për të ndezur sërish ndriçimin. Ndërroni ndriçimin LED → Kapitulli "Ndriçimi (LED)".

Defekti	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Mbi dysHEME pikon ujë	Ena e avullimit poshtë në anën e pasme të pajisjes nuk është niveluar mirë ose tubi i shkarkimit nuk është pozicionuar si duhet mbi enë. Mbajtësja e akullit/ujit ka shkrirë sepse pajisja nuk ka pasur energji.	Kontrolloni enën e avullimit dhe tubin e shkarkimit në anën e pasme të pajisjes. Kontrolloni mbajtësen e kubave të akullit dhe nëse nevojitet, boshatiseni.
Dispenseri i ujit nuk funksionon	Depozita e ujit është bosh ose nuk është futur saktë. Siguresa e fëmijëve është aktive ose dera e dhomës së ngrirjes nuk është mbyllur.	Kontrolloni depozitën e ujit. Çaktivizoni siguresën e fëmijëve. Mbyllni derën e dhomës së ngrirjes.
Nuk mund të nxirret akull	Pas instalimit, duhen disa orë që dhoma e ngrirjes të arrijë temperaturën e saj dhe të mund të prodhohen kuba akulli. Kubat e akullit janë ngjitur bashkë në mbajtësen e kubave të akullit ose janë ngecur tek pjesa e nxjerrjes. Akullbërësi është fikur.	Kontrolloni pjesën e nxjerrjes. Kontrolloni mbajtësen e kubave të akullit dhe nëse nevojitet, boshatiseni. Aktivizoni akullbërësin.

Shërbimi i klientit

Shërbimin e klientit në afërsi e gjeni në librin telefonik ose në regjistrimin e pikave të shërbimit të klientit. Jepini shërbimit të klientit numrin e produktit (E-Nr.) dhe numrin e prodhimit (FD-Nr.) të pajisjes.

Këto të dhëna i gjeni tek tabela e tipit.



Ju lutemi përmendeni numrin e produktit dhe atë të prodhimit për të shmangur ecejake të panevojshme. Në këtë mënyrë kurseni kosto të shtuara.

Kontrata e riparimeve dhe këshillimi në rast defektesh

Të dhënat e kontaktit të gjithë vendeve i gjeni në regjistrin e pikave të shërbimit të klientit.



Thank you for buying a Bosch Home Appliance!

Register your new device on MyBosch now and profit directly from:

- **Expert tips & tricks for your appliance**
- **Warranty extension options**
- **Discounts for accessories & spare-parts**
- **Digital manual and all appliance data at hand**
- **Easy access to Bosch Home Appliances Service**

Free and easy registration – also on mobile phones:

www.bosch-home.com/welcome



Looking for help? You'll find it here.

Expert advice for your Bosch home appliances, need help with problems or a repair from Bosch experts.

Find out everything about the many ways Bosch can support you:

www.bosch-home.com/service

Contact data of all countries are listed in the attached service directory.

Bosch Home Appliance Group

P.O. Box 83 01 01

D-81701 Munich

Germany

www.bosch-home.com



9001676939 (0108)

sq